

14. Permbledhje jo teknike POWER INDUSTRIES SHPK

14.1 Hyrje

Studio e konsulences “Green Hours” shpk eshte studio e paisur me Licence LN-7408-02-2014 per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditim mjedisor, perhartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirjen si ekspert per te vleresuar nje raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi.

“Green Hours” shpk eshte e certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave sipas Vendimit Nr 3, Nr 197 regjistri, Nr 324 prot, date 20.04.2006.

Prane studios “Green Hours” shpk punon si drejtues teknik eksperti mjedisor Denis Harasani I paisur me Certifikate nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave me Nr 5116 Prot, Nr identifikues 143, date 08.07.2013.

“Green Hours” shpk eshte e regjistruar ne QKR dhe eshte e paisur me NIPT K61626009I

Me kerkese te perfaqesuesit ligjor z. Andi Marku, gjate periudhes Prill-Qershor, studjo e konsulences “Green Hours” shpk pergatiti Kerkesen per Leje Mjedisore te Tipit B per aktivitetin e shoqerise Power Industries.

Power Industries ka filluar aktivitetin prodhues dhe tregtar ne vitin 2013 dhe bazuar ne kerkesat e legjislacionit shqiptar, ka kerkuar pergatitjen e dokumentacionit per tu paisur me Leje Mjedisore te Tipit B.

Aktualisht, admisnistratori (perfaqesuesi ligjor z. Andi MARKU) ishte e impenjuar ne procesin e realizimit dhe krijimit te kushteve per pergatitjen e dokumentacionit te plote.

Bazuar ne legjislacionin per mjedisin, duke i u referuar investimit te kryer, kapaciteteve magazinuese, teknologjise se rruajtjes, cilesise se aksesoreve dhe cilesise se produktit per treg, mendojme qe subjekti permbush kriteret per paisjen me Leje Mjedisore te Tipit B

Procesi i pergatitjes se kerkeses u realizua sipas hapave te me poshteme:

- Njohja me subjektin qe ushtron aktivitetin
- Njohja me objektin ku zhvillohet aktiviteti
- Njohja me problematiken e pergjitheshme dhe natyren e aktivitetit
- Njohje me projektet dhe funksionet e cdo objekti
- Identifikimin e ndikimit ne floren dhe faunen ekzistuese
- Identifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve te ndara sipas natyres

- a. Mbetje te ngurta
 - b. Shkarkime ne ajer
 - c. Shkarkime ne uje
- Njohje me masat e mara per trajtimin e mbetjeve
 - Identifikimi i mundesive per minimizimin e ndikimit

Rezultatet e ketij vleresimi paraqiten ne kete permbledhje jo teknike me qellimin final:

- Vleresimin e ndikimit ne flore e faun
- Vleresimin e ndikimit ne peisazh
- Vleresimin e bilancit te shkarkimeve ne ajer.
- Vleresimin e shkarkimeve ne ujrata siperfaqesore dhe nentokesore:
- Trajtimin mjedisor te mbetjeve te ngurta
- Hartimin e programit te monitorimit

ANEKSI 14

TABELA:


STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM

Hyrje

| | |
|--|-----------|
| 1. <u>INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR</u> | 51 |
| 2. <u>PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.</u> | 52 |
| 3. <u>INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.</u> | 55 |
| 4. <u>IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.</u> | 66 |
| 5. <u>PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.</u> | 68 |
| 6. <u>INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.</u> | 68 |
| 7. <u>SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS</u> | 69 |
| 8. <u>REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.</u> | 69 |
| 9. <u>MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.</u> | 69 |
| 10. <u>NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).</u> | 70 |

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B



Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedis Tipi B

▪ **INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR**

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmblodhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktorë të ndryshëm, njerëzore dhe natyrore. Nder ligjet më kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.**

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedis Tipi B

- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.
 - Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
 - Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.
 - Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
 - Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se VNM-se”.
 - Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.
 - Vendim Nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.
 - Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave.
- **PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.**

Aktiviteti ne vleresim eshte nje Autoservis makinash i ndodhur ne rrugen “Hamdi Sulcebej”, njesia 4, Tirane. Ky objekt ndodhet ne brendesi te qytetit te Tiranes dhe si rrjedhoje nuk prek as bimesi as zona natyrore me status te vecante. Ne kete zone ka nje zhvillim urban intensiv, ku dominojne banimet individuale por edhe ndertimet e pallateve te viteve te fundit. Bimesia e zones ndodhet shume larg, mund te permendim ate te Malit te Dajtit, por per kete objekt nuk kemi bimesi per te pershkruar.

Ortofoto e siperfaqes ne vleresim




Foto te objektit dhe aktivitetit

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B



Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lurë, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Parku Kombetar "Mali i Dajtit" (Kategoria II)

Ndodhet në Qarkun e Tiranës dhe në rrethin e Tiranës. Sipërfaqja aktuale 29,384,18 ha. Zonë me vlera peizazhore, kulturore dhe historike e tradicionale. Në këtë park shprehen mjaft mirë zonat fitogjeografike: makja mesdhetare, dushkajat (Quercetum), ahishtet (Fagetum) dhe kullotat subalpine e alpine. Takohen dhe drurë të rrallë e të mbrojtur të gështënjes dhe arrës. Ndër gjitarët veçojmë praninë e ujkut (Canis lupus), ariut (Ursus arctos), derrit të egër (Sus scrofa), kunadhës (Martes foina) dhe maces së egër (Felis sylvestris). Vlerave të saj shkencore dhe didaktike u shtohen dhe ato peizazhore, shlodhëse, argëtuese dhe historike e kulturore, që përbëjnë dhe potenciale për zhvillimin e turizmit. Në park përfshihen formacione të ndryshme gjeologjike dhe liqeni i Bovillës. Ka plan menaxhimi.



Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:

a) Në Veri: Kufiri ndërmjet rrethit të Krujës dhe të Tiranës, Maja e Fraveshit (794 m)-(4403610.75L/4595619.92V), vijon me kuotat 1090.0 m, 1227.0 m (Maja e Zithit), 1627.0 m deri te maja Henzit (1807.0 m)-(4411214.23L/4598279.97V);

b) Në Lindje: Maja Henzit (1807.0 m)-(4411214.23L/4598279.97V), ndjek kurrizin e vargmalit Xibër-Malin me Gropa, me kuotat 1473.0 m (Maja e Rjepes), 1388.0 m, 129.05 m, 161.03 m (Maja e Popatit), 1455.0 m (Maja e Strervecit), 1594.0 m, 1700.0 m, 1827.0 m (Maja e M.Shemberise), 1712.0 m, 1498.0 m, deri te ndërprerja me rrugën automobilistike Tiranë-Bizë, në afërsi të fshatit Burimas dhe rrjedhjen e lumit Erzen, kuota 542.0 m(4421481.54L/4576965.76V);

c) Në Jug: Kuota 542.0 m (4421481.54L/4576965.76V), ndjek rrjedhën e lumit Erzen, kalon nëpër ujëmbledhësin e Skoranës, Grykën e Skoranës deri te kuota 444.0 m (4412192.02L/4569269.69V);

d) Në Perëndim: Grykën e Skoranës deri te kuota 444.0 m (4412192.02L/4569269.69V), vijon me kuotat 890.0 m (Maja e Kuorës), pranë fshatit Përcëllesh, në Priskën e Madhe, vazhdon me rrugën automobilistike Priskë-Surrel, ndjek rrugën automobilistike Surrel-Tiranë deri në afërsi të komunës së Dajtit, në kuotat 573.0 m (Maja e Qytezës), 445.0 m (Maja e Shpatës), në afërsi të fshatit Brar dhe Priskë e Vogël, ndërpret lumin e Tërkuzës, kuotat 1268.0 m (Maja e Gamtitit) deri te Maja e Fraveshit (794.0 m)-(4403610.75L/4595619.92V).

▪ INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zbatimit te ketij projekti nuk ka burime ujore te identifikuar. Objekti ndodhet ne brendesi te qytetit te Tiranës dhe nuk ndodhet ne brendesi apo ne afersi te burimeve ujore te rendesishme si Lumenjte kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Ne

Shtojca 2


Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

afersi te zones ndodhen vetem disa “Liqene” te vegjel(Rezervuar), si dhe disa “Lumenj” te cilet pershkruajne rajonin e Tiranes, ku ai me i afert me siperfaqen ne vleresim eshte lumi i Lanes. Lumenjte e Rajonit te Tiranes jane: Lumi i Tiranes, Lumi i Lanes, Lumi Erzen, Lumi Terkuze dhe me tej Lumi Ishem te cilet e kane grykederdhjen ne Detin Adriatik, i cili eshte edhe burimi uJOR me i madh i rajonit.

Gjithashtu ne afersi te zones ne vleresim ndodhet edhe Rezervuari i “Liqenit Artificial te Tiranes”. Ndersa per rajonin mund te permendim liqenin e Bovilles ne zonen e Dajtit, Liqenin e Farkes, si dhe nje numer i madh rezervuaresh bujqesor te ndertuar gjate periudhes se para viteve `90, si ato te Kasharit, te Vores, te zones se Ndroqit, te Paskuqanit te Pezes, te Baldushkut, etj.



Pozicionimi ne lidhje me burimet uJore



Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

1 Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.

2 Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MM. Sic shihet edhe ne hartën e meposhteme, zona ne vlerësim permban zonat e mbrojtura si meposhte:

3

Monumentet Natyrore te Rrethit Tirane.(Sipas VKM 676)

| | |
|------------------------------|-----------------------|
| Bokerimat e Mustafa Koçajt | Gryka e Murdarit |
| Shpella e Shutresë | Shkalla e Tujanit |
| Shpella e Zezë (Pëllumbasit) | Bokerimat e Mnerit |
| Shpella e Valit | Rrapi i Priskës |
| Tarraca detare e Dajtit | Rrapi i Kranës – Dajt |
| Karsti i Malit me Gropa | Rrapi i Ndroqit |
| Gryka e Skoranës | Arra e Babë Myslymit |


4

5

6 Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B



Mjedisi social-ekonomik

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedis Tipi B

Popullsia

Sipas CENCUS 2011, popullsia e Shqipërisë është 2.8 milion banorë me një rënie prej 8% në dy dekadat e fundit. Gjatë periudhës 2001-2013, në Shqipëri, popullsia banuese është reduktuar në 10 qarqe dhe ka shënuar rritje vetëm në dy qarqe. Rënia e popullsisë përgjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin ka qenë 8.2 për qind, por në Gjirokastrë popullsia ka rënë me 35.7 për qind ndërsa në Tiranë është rritur me 26.1 për qind. Në vitin 2013, qarku me popullsinë më të vogël ishte Gjirokastra me afërsisht 68 mijë banorë ndërsa qarku me popullsinë më të madhe ishte Tirana me 766 mijë banorë.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Bazuar në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe Procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit", MM nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik ka realizuar projektin "Monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetet kryesore të vendit tonë" si Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë për vitin 2013.

Veprimtaria studimore e monitoruese, është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Vlerësimi dhe studimi i treguesve mjedisorë të gjendjes dhe ndikimit në mjedis
- Realizimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM10, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX në stacione të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të refl ektuara edhe në VKM nr 803, datë 4.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit". Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohës vjetore. Të dhënat e monitorimit për pluhurat (PM10 dhe PM2.5) realizohet orare .

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mesatare për treguesit e monitoruar

Tab. 1 Të dhënat mesatare vjetore

| Nr | Stacionet | PM10 | PM2.5 | NO ₂ | O ₃ | SO ₂ |
|----|-----------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| | | ug/m ³ | ug/m ³ | ug/m ³ | ug/m ³ | ug/m ³ |
| 1 | Tirana qender | 33.5 | 17.8 | 41.6 | 49.4 | - |
| 2 | ISHP | 31.8 | 15.3 | 13 | 52.66 | - |
| 3 | Vlore | 34.37 | 16.11 | 7.25 | 75.25 | - |
| 4 | Korce | 27.52 | - | 5.06 | 66.2 | 5.83 |
| 5 | Norma shqiptare | 60 | 15 | 60 | 65 | 60 |
| 6 | Standarti I BE | 40 | 25 | 40 | - | - |

Situata për ndotjen nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} . Pluhurat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut.

Ndotja nga PM10 dhe PM2.5 sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkrive.


Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM10.

GRAFIKU 1

Vlera vjetore e PM10




Nga rezultatet e monitorimit të PM10 dhe PM2.5, sic vihet re dhe nga figura 1, përmbajtja mesatare vjetore e PM10 nuk e tejkalon normën Shqiptare dhe standartin e BE në asnjë nga stacionet e monitoruara por problematik ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ku kemi tejkalim të ditëve që janë më të larta se norma ditore (Norma është 35 ditë të tejkaluara në vit).

Ndërsa përsa i përket PM_{2.5} mud të themi në të tre stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës vjetore të PM_{2.5} krahasuar me standartin vjetor Shqiptar në vlera të ulëta. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim prej afërsisht 10%, në stacionin e ISHP është afërsisht sa norma ndërsa në stacionin e poliklinikës qendrore kemi një tejkalim prej afërsisht 20%.

GRAFIKU 2

Vlerat vjetore te PM2.5



Kjo ndotje për PM10 dhe PM2.5 vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve që lëvizin në rrugët me trafi k të rënduar, cilësia e lëndës djegëse, menaxhim joefi kas i trafi kut që shpie në dyndje dhe në kohë qëndrimi të gjatë si dhe mirëmbajtja e automjeteve.


Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Përmbajtja e ndotësive të gaztë (NO₂, SO₂)

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, si duket dhe nga grafi ku i mëposhtëm ajri urban në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (SO₂ dhe NO₂), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të normës Shqiptare dhe standartit të BE përjashtim bën Tirana qendër ku kemi tejkalim të lehtë të standartit të BE. Kjo është e pritshme pasi burimi kryesor i ndotjes në zonën përreth stacionit është trafiku i automjeteve që të shumta janë në orët e mëngjesit dhe të mbrastit.



Ndotësit Fotokimik

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësive primare dhe përbërësve të tjerë të atmosferës. Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban. Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e

atmosferës. Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Në grafi këtë mëposhtëm janë të dhënat vjetore në stacionin e Vlorës dhe Korçës krahasuar me normën vjetore Shqiptare ku shihet qartë se kemi një tejkalim të kësaj norme në të dy stacionet e monitoruara. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim në masën 16 % ndërsa në stacionin e Korçës kemi një kapërcim të ulët të kësaj norme.


Në grafi kun nr 5 kemi vlerat 8 orarëshe për periudhën në dy stacione të Poliklinikës qendrore dhe ISHP-së për periudhën Janar-Dhjetor 2013. Nivelet e larta të ozonit hasen në muajt e verës për efekt të rrezatimit më të fortë diellor.

Shtojca 2

Kerkesa per Leje Mjedisi Tipi B

GRAFIKU 4

Vlerat vjetore te O₃



Zhurmat

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qytetit te Tiranës duke qene se ky qytet ka ne disa pika te tij trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Ndonese kjo zone eshte me me pak trafik dhe rruge te renduara nga trafiku, eshte nje zone e prekur ndjeshem nga zhvillimet si ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit ashtu edhe ne zhvillimin industrial e tregtar, kryesisht zona pergjate autostrades "Tirane-Durres". Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar.

Studimi i Gjendjes së Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të Shqipërisë

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve Drin, Buna, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjose është kryer në bazë të rezultateve të parametrave fiziko-kimike (temperatura, transparenca, pH, alkalinitet, percjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal) bërë në 18 stacione. Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Ohrit, Prespës dhe Shkodrës realizohet për treguesit fiziko-kimike në 5 stacione. Monitorimi është kryer nga IEUM. Kohzgjatja e studimit Qershor-Dhjetor 2012. Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pëllgjeve lumore. Në aneks do të gjeni stacionet lumore dhe liqenore, të dhënat gjeografi ke të tyre dhe kodin në rrjetin e monitorimit si dhe rezultatet mesatare të monitorimit për 2012 Vlerësimi i cilësisë së ujrave të lumenjve dhe liqeneve dhe krahasimi i vlerave të parametrave kimike me normat përbën një nga kërkesat e në Direktivat e Bashkimit Evropian për monitorimin e gjendjes së ujrave sipërfaqësore Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve janë përdorur vlerat limite të përcaktuara në Direktivën e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659,

për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve dhe klasifi kimi i cilësisë së ujërave të ëmbla natyrore sipas Institutit për Studimet e Ujërave të Norvegjisë – NIVA.

Sipas këtij klasifi kimi, parametrat e cilësisë së ujërave të ëmbla mund të ndahen në dy grupe:

1- në grupin e parë bëjnë pjesë ushqyesit, lëndët organike, përbërësit acide, grimcat e ngurta dhe bakteriet e fekaleve në ujëra.

2- në grupin e dytë metalet e rënda në nivelet mikro në ujë, sedimente dhe peshq.

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Për vendmatjet lumore: temperatura, pH, alkalinitet, përcjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal.

Temperatura e ujit ka një shpërndarje të vlerave të tyre sipas stines dhe në përgjithësi me të njëjtën ecuri si edhe temperatura e ajrit. Prania e gazit karbonik në ujëra me alkalinitet të ulët i bën ato lehtësisht agresive. Ujrat me alkalinitet të lartë mbi 5 mg.ekuiv./L turbullohen shpejt gjatë qëndrimit të tyre në mjedis.

Lumi Ishëm:

- Janë monitoruar 2 stacione : Ura e Brarit dhe Ura Salme-Shetaj. Stacionet janë vendosur në pjesën e sipërme të lumit dhe në pjesën e poshtme të tij para derdhjes në det.

- Temperatura e ujit varion 25.7 – 27.10C në Urën e Brarit dhe në Salme Shetaj në Qershor dhe 16.8 -18.4 në fazën e dytë në muajin tetor. - pH i UN varion nga 7.89 - 8.32 respektivisht për stacionet Salme Shetaj dhe Ura e Brarit. Luhatjet stinore janë te ulta në vlerat 0.05 – 0.15. Ujrat janë neutrale, sipas Direktives Kuadër të ujit norma e lejuar për ujrat e ëmbla është (Ph = 6.5 – 8.5).

- Alkaliniteti– Në këtë fazë vlerat luhaten nga 160 – 343 mol/l sipas stacioneve respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. - Përcjellshmëria elektrike – Luhatet në vlerat 336 - 829 μ S/cm respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. Luhatjet stinore janë të ndjeshme rreth 100 μ S/cm nga stina në stinë. - Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Ishëm luhatet në vlerat 2.38 – 7.5 mg/l. Në fazën e dytë të monitorimit përmbajtja e oksigjenit ulet ndjeshëm në të dy stacionet. Kjo duket lehtësisht në paraqitjen grafi ke. Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Ishëm është vlera më e ulët e takuar në të gjithë lumenjtë gjatë këtij viti. Vlerat mesatare të stacioneve janë gati të njëjta 4.46 dhe 4.49. Në vlerësimin e DKU për përmbajtjen e oksigjenit ujrat e lumit Ishëm klasifi kohen të cilësisë së keqe. Ndryshimet stinore si dhe klasifi kimi i stacioneve sipas cilësisë dallohen shumë qartë grafi kisht.

- Vlerat e përmbajtjes së BOD5 luhaten nga 0.6 në 4.11 mg/l. Vlerat mesatare të secilit stacion janë 1.2 dhe 3.95 mg/l. Vlerësimi i cilësisë së ujit sipas përmbajtjes së BOD5 klasifi kohet si i gjendjes së moderuar.

Paraqitja grafi ke pasqyron qartë luhatjet e përmbajtjes së BOD5 gjatë monitorimit të këtij viti si dhe klasifi kimin cilësor të stacioneve : Ura e Brarit dhe Salme Shete.

Vlerat e përmbajtjes të nevojës kimike për oksigjen- NKO luhatet në 0.52 – 1.52 – 3.64 mg/l në Ura e Brarit dhe në Salme Shetaj. Në fazën e dytë përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen rritet nga 0.8 - 3.2 mg/l.

- Përmbajtja e fosforit total në lumin Ishëm luhatet në vlerat 0.03 – 1.52 mg/l. Luhatjet sezonale në stacionin Ura e Brarit janë të lehta ndërsa në stacionin Salme Shete luhatjet janë të theksuara, gjithashtu në këtë stacion takohet dhe vlera max për vitin 2013. Përqëndrimi i fosforit është i lartë duke i tejkaluar normat dhe duke bërë që ujrat e lumit Ishëm të klasifi kohen si të cilësisë së keqe.

- Amoniaku është tregues i ndotjes bakteriale të ujrave. Vlerat e marra nga monitorimi i këtij viti janë nga 0 – 3.06 mg/l. Në 2 stacionet e lumit Ishëm vëmë re rritje të vlerave gjatë fazes së dytë të monitorimit. Vlerat e amoniakut në stacionin Salme Shete janë mbi norma duke bërë që ujrat e lumit Ishëm të klasifi kohen si të cilësisë së keqe, ndërsa e kundërta ndodh në stacionin Ura e Brarit ku cilësia është e nivelit mirë.


Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B


- Vlerat mesatare të përmbajtjes së nitrateve luhaten nga 1.33 – 1.45 mg/l, respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shete. Luhatjet nga periudha ujëshumtë në periudhën ujëpaktë nuk janë të mëdha. Vlerësimi i cilësisë sipas përmbajtjes së nitrateve është i nivelit mirë $\text{NO}_3 < 2 \text{ mg/l}$.

- Vlerat e përmbajtjes së Nitriteve luhaten nga 0 – 0.08 – 0.45 mg/l për stacionet Ura e Brarit dhe Salme Shete. Në grafi kun e përmbajtjes së nitriteve vërehen luhatjet nga stina në stinë. Vlerat limite të përmbajtjes së nitriteve sipas DKU i përcaktojnë ujrat e lumit Ishëm si ujra me gjendje të moderuar deri të keqe $\text{NO}_2 < 0.12 \text{ mg/l}$ dhe $\text{NO}_2 > 0.3 \text{ mg/l}$ duke tentuar rejt gjendjes së varfër. Zona ku takohen përmbajtje të larta të nitriteve është stacioni Salme Shete. Lëndët Pezull - kanë luhatje në vlera nga 12.4 në 226.3 mg/l për stacionet Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. Luhatjet sezonale janë të larta nga 113.6 – 213.9 mg/l. Vihet re një rritje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve. Vlerat e takuara të lëndëve pezull në lumen Ishëm janë më të lartat e takuara deri më tani në të gjithë lumenjtë.

Permbajtja e P_{total} ne lumin Ishëm AL040




Përmbajtja e NH_4 në lumin Ishëm AL 040




Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisi Tipi B

Përmbajtja e NO₃ në lumin Ishëm AL 040



Përmbajtja e NO₂ në lumin Ishëm AL 040



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2013, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedis Tipi B

▪ IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujerat te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lyerjes se makinave ne furren e lyerjes dhe tharjes se bojës. Me qellim uljen e pluhurit dhe gazit te demshem ne dhomen e lyerjes dhe te stukimit e te lustrimit ne tavan jane instaluar ventilatore per thithjen e ajrit dhe ne dysheme ndodhet nje kanal ne te gjithe perimetrin e objektit, i cili mbushet me uje, rreth 0.5m³ dhe ne te cilin shkarkohen pluhurat e lustrimit dhe te bojës qe emetohet ne ajer gjate lyerjes. Keto ujera, pas perfundimit te procesit,

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisori Tipi B

kalojne ne kolektorin kryesor, dekantohen dhe me pas shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Keto ujera nese shkarkohen ne mjedisin uhor prites(lum, liqen, det, etj.), ndikojne ne demtimin dhe largimin e faunes dhe flores ujqore. Efekti i tyre shkakton kontaminim te ujit.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga procesi i lustrimit te stukos dhe bojës, si dhe nga aerosoli i shkaktuar nga procesi i ljerjes me boje te automjeteve. Keto shkarkime, pa nje sistem filtrimi, shkaktojne ndotjen e ajrit te zones dhe per pozicionin qe ka objekti, duhet te instaloje filtra per ajrin qe del nga sistemi i aspirimit.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga perdorimi i gurit flesibel per prerjen e llamarinave te demtuara, nga kompresoret e prodhimit te ajruit me presion, nga aspiratoret dhe ventilatoret ne ambjentet e autoservisit.

Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit(Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa mund te mos jene te detyrueshme. Nuk do te shkaktohen vibrime.

Ndikimi ne toke

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke. Sheshet jane te shtruara dhe nuk ka kontakt me mjedisin tokesor. Nuk ka filtrim te ujerave sipërfaqesore ne toke.

Ndikimi ne Biodiversitet

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor. Aktiviteti ndodhet ne nje zone urbane dhe vetem ujerat e pergjithshme te qytetit ndikojne ne mjedisin biologjik dhe fizik te rajonit te Tiranes dhe te mjediseve ujqore si Deti Adriatik dhe lumenjte e rajonit.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit qe ofron, konkurrences ne treg dhe uljes se cmimeve, etj. Efekti negativ i vetem eshte ne rastet e shkarkimit te ujerave pa trajtuar dhe te clirimit te ajrit te aspiratoreve te dhomes se ljerjes dhe te stukimit e zmerilimit. Per te shmangur keto efekte, subjekti duhet te jete pajisur me vaska dekantuese dhe sistem teper efektiv e te disponueshem per te dekantuar ujin dhe per te trajtuar ate kimikisht. Objekti duhet te funksionoje i pajisur me filtra she te mos punoje ne oret e vona, kjo per shkak te afersise me objektet e banimit qe ka fare prane.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen do te jene ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem, metalet si pjese kembimi apo ambalazhe, jane te riciklueshme dhe shiten si skrap metali. Llumi i

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedis Tipi B

vaskave dekantuese, kerkon trajtim te integruar dhe perdorim te tij ne zona ku nuk demtohet mjedisi biologjik, uxor dhe ai i tokave bujqesore.

▪ **PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujerat te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lyerjes se makinave ne furren e lyerjes dhe tharjes se bojës. Me qellim uljen e pluhurit dhe gazit te demshem ne dhomen e lyerjes dhe te stukimit e te lustrimit ne tavan jane instaluar ventilatore per thithjen e ajrit dhe ne dysHEME ndodhet nje kanal ne te gjithe perimetrin e objektit, i cili mbushet me uje, rreth 0.5m³ dhe ne te cilin shkarkohen pluhurat e lustrimit dhe te bojës qe emetohet ne ajer gjate lyerjes. Keto ujera, pas perfundimit te procesit, kalojne ne kolektorin kryesor, dekantojne dhe me pas shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Keto ujera nese shkarkohen ne mjedisin uxor prites(lum, liqen, det, etj.), ndikojne ne demtimin dhe largimin e faunes dhe flores ujore. Efekti i tyre shkakton kontaminim te ujit.

Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga procesi i lustrimit te stukos dhe bojës, si dhe nga aerosoli i shkaktuar nga procesi i lyerjes me boje te automjeteve. Keto shkarkime, pa nje sistem filtrimi, shkaktojne ndotjen e ajrit te zones dhe per pozicionin qe ka objekti, duhet te instaloje filtra per ajrin qe del nga sistemi i aspirimit.

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga perdorimi i gurit flesibel per prerjen e llamarinave te demtuara, nga kompresoret e prodhimit te ajruit me presion, nga aspiratoret dhe ventilatoret ne ambjentet e autoservisit.

Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit(Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa mund te mosjane te detyrueshme. Nuk do te shkaktohen vibrime.

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke. Sheshet jane te shtruara dhe nuk ka kontakt me mjedisin tokesor. Nuk ka filtrim te ujerave siperfaqesore ne toke.

▪ **INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne nje vit.

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisori Tipi B

▪ **SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance me dhjetera metra, ose deri ne 100m, kjo persa i perkete ndikimit te zhurmës, ajrit te perzier me aerosolin e bojës. Ndersa ndikimi ne ujera nese do te shkarkohen ne mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do te shtrinte ndikimin e tij deri ne disa km, ose dhjetra km. Ujerat e gjeneruar nga aktiviteti kane ndotje kimike, si rrjedhoje duhett e trajtohen patjeter. Per parandalimin e ketyre efekteve, subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet teknike. Duhet te kontrolloje dhe mirembaje vaskat dekantuese te shkarkimit te ujerave, dhe uji te perdoret me riqarkullim me cikël te mbyllur.

▪ **REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.**

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedisori i ketij aktiviteti duke qene objekt banimi dhe nuk ka mjedis biologjik, mund te rehabilitohet shume shpejt dhe pa kosto. Ne rast te mbylljes apo ndryshimit te vendodhjes se instalimit, ky mjedis te rehabilitohet plotesisht dhe te shnderrohet ne nje mjedis te paster e te kendshem per ambjent banimi.

▪ **MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Duhet te trajtohen ujerat qe dalin nga dhoma e lysterjes dhe lustrimit te makinave, para shkarkimit te tyre ne sistemin e kanalizimeve.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme.
- Te ajroset vazhdimisht ambjenti i punes dhe punonjesit gjate lysterjes e lustrimit te perdorin maska mbrojtese me fibra karboni e sistem tjetër te kapjes se pluhurave te imeta.(teper e rendesishme per shendetin e punonjesve).
- Punëtorët që do të ndodhen në mjediset ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).
- Te mos punohet ne oret e vona, pasi afersia me banesat mund te shnderrohet ne nje shqetesim serioz per banoret e zones.
- Te gjitha mbetjet e ngurta te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per menaxhimin e tyre.
- Te perdoren bojera ekologjike dhe te mos derdhen ne asnje menyre ne sistemin e kanalizimeve.

Shtojca 2

Kerkese per Leje Mjedisori Tipi B

- Te nderrohen shpesh filtrat dhe aspiratoret per nje funksionim optimal te tyre dhe per reduktimin e zhurmes.
- Filtrat e pastrimit te ajrit te menaxhohen nga subjekte te licensuara per kete lloj aktiviteti.

▪ **NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky aktivitet nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Aktiviteti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushte normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.